



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 25.07.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "OFFICE I KOSOVA" për aktivitetin: <"Furnizimi me libra për bibliotekat shkollore dhe Biblioteken "Hivzi Sylejmani"> dhe me numër të prokurimit: **616 -19-2096-121** nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "OFFICE I KOSOVA" e datës 22.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit <"Furnizimi me libra për bibliotekat shkollore dhe Biblioteken "Hivzi Sylejmani">, me nr.616 19 2906 121 kundër *Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK –së*, të datës 15.07.2019, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimi të KRPP-së.

1. **VERTETOHET Njoftimi i Vendimit për dhënje të kontratës** i publikuar me datë: **15.07.2019**;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Office 1 Kosova**" me datë 22.07.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: < Furnizimi me libra për bibliotekat shkollore dhe Biblioteken "Hivzi Sylejmani"> me Nr.616 19 2906 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 25.07.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar drejt sipas nenit 59 dhe 72.3 është plotësisht i pa bazuar për faktin që e keni cekur edhe ju vetë se AK-ja mund të kërkojë sqarime shtese lidhur me dokumentet e dorezuara, por nuk ka të drejtë të kërkojë plotësim të dokumentacionit që ka origjinë pas ditës së fundit të caktuar për dorëzimin e tendereve. Lidhur me eliminimin tuaj ju sqarojmë se të gjitha kërkesat në dosje kanë

qene te qarta dhe nga kjo rrjedh se te gjitha dokumentet qe i keni poseduar deri ne ditën e fundit per dorezim te tenderit jane pjese e tenderit tuaj dhe qfardo kerkese per plotesim do te ishte e pa ligjshme dhe do te nenkuptonte pranimin e dokumenteve qe jane me origjine pas asaj dite;

-Pretendimi tjeter se marreveshjet e tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates jane me organizata qe nuk jane shtepi botuese,por OJQ dhe individ ju sqarojme se te gjithë ata jane te autorizuar per botimin e librave qe jane paraqitur nga i njejti ne ato marreveshje.Ne kemi verifikuar kete dhe konstatimet tona jane si vijon:

Te gjitha marreveshjet e dorezuara nga tenderuesi i propozuar jane valide dhe te bazuara pasiqe hulumtimet tona na kane bindur se partneret e paraqitur ne marreveshje jane ose shtepi botuese,ose shtypshkronja me autorizim te veçante te ndonje autori per botim te librit,apo institute dhe individ qe kane te drejta ekskluzive per botimin e veprave te caktuara.Poashtu kemi verifikuar edhe ekzistencen fizike te librave sipas jush te te kontestuar dhe kemi konstatuar se te njejtë jane te botuar nga partneret e marreveshjeve te paraqitura.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese(nepermes Platformes elektronike;
- Njesisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit;dhe
- Anëtarëve të komisionit